Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 16 dhjetor 2011

Lënda nr. 310/09

Velibor AĐANČIĆ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 16 dhjetor 2011,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znnj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pa shqyrtimit të ankesë së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u paraqit më 18 shtator 2009 dhe u regjistrua në të njëjtën ditë.

2. Më 3 tetor 2011, Paneli kërkoi nga ankuesi të paraqesë informacione shtesë. Më 10 nëntor 2011, Paneli pranoi informacionet e kërkuara nga ankuesi. Më 12 dhjetor 2011, Paneli kërkoi informacione shtesë nga ankuesi, që u siguruan të njëjtën ditë.

II. FAKTET

3. Ankuesi është banor i Kosovës. Ai pretendon se është pronari aktual i pronës së paluajtshme dhe i disa parcelave të tokës që ndodhen në fshatin Babi Most, në komunën e Obiliqit. Ankuesi thekson se prona e lartcekur më përpara ka qenë në pronësi të nënës së tij të ndjerë, me të cilën ai jetoi deri në vendosjen e KFOR-it në qershor të vitit 1999, kur ata u detyruan që të largohen. Ai thekson se është njoftuar se një pjesë e pasurisë së tij ishte dëmtuar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999, kurse një pjesë tjetër e pasurisë ishte uzurpuar.

A. Procedura gjyqësore

4. Më 5 gusht 2004, nëna e ankuesit parashtroi padi në Gjykatën komunale të Prishtinës kundër komunës së Obiliqit dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e shtëpisë së saj dhe të ndërtesave përreth që ndodheshin në pronën e saj në fshatin Babi Most, në parcelat kadastrale nr. 1124/1 dhe 1124/2.

5. Më 8 shtator 2004, nëna e ankuesit vdiq. Ankuesi u bë pronar i parcelave kadastrale nr. 1124/1 dhe 1124/2.

6. Kah fundi i vitit 2008, Gjykata komunale në Prishtinë nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishin caktuar seanca dëgjimore lidhur me padinë e lartcekur.

7. Në vitin 2004 u paraqitën rreth 17,000 kërkesa për kompensim pranë gjykatave të Kosovës, shumica prej tyre nga serbët e Kosovës, të cilët për shkak të luftës i kishin braktisur shtëpitë e tyre në Kosovë në vitin 1999 dhe prona e të cilëve më vonë ishte dëmtuar apo shkatërruar. Me qëllim të përmbushjes së afatit të parashkruar pesëvjeçar për paraqitjen e kërkesave civile për kompensim, këta ankues i parashtruan kërkesat e tyre rreth kohës së njëjtë në vitin 2004. Kërkesat u ishin drejtuar disave si UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (më tutje: HRAP), *Milogorić dhe të tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendim i 24 marsit 2010, § 1; për bazën ligjore në të cilën ankuesit i bazuan kërkesat e tyre, shih mendimin e njëjtë § 5).

8. Lidhur me këto raste, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut (DD) u dërgoi një shkresë të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe atyre të qarkut dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës më 26 gusht 2004. Në atë shkresë, Drejtori

i DD theksoi se ishin parashtruar "mbi 14,000" kërkesa të tilla. Ai iu referua "problemit që do të paraqiste një fluks kaq i madh i kërkesave për gjykatat", dhe kërkoi që "asnjë rast [i tillë] të mos caktohet për shqyrtim derisa bashkërisht të vendoset se si më së miri të procedohen këto raste" (për tekstin e plotë të shkresës, shih mendimin *Milogorić dhe të Tjerët*, të cituar në § 7 lart, në § 6).

9. Më 15 nëntor 2005, DD ftoi gjykatat të fillojnë procedimin e kërkesave për dëmet e shkaktuara nga persona të identifikuar fizikë dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit 2000, duke konsideruar se "pengesat për procedimin efikas të këtyre rasteve" më nuk ekzistonin. Kërkesat që kishin të bënin me ngjarjet para tetorit 2000 nuk ndikoheshin nga kjo shkresë.

10. Më 28 shtator 2008, Drejtori i DD informoi gjykatat që rastet të cilat nuk ishin caktuar për shqyrtim në pajtim me kërkesën e 26 gushtit 2004, të procedohen tani.

11. Më 10 shtator 2008, ankuesi parashtroi kërkesë të re në gjykatën komunale të Prishtinës, këtë herë duke kërkuar dëbimin e dy të paditurve për të cilët diheshin emrat, për të cilët pohohej se ilegalisht kishin uzurpuar pjesë të pasurisë së tij (parcelat kadastrale me nr. 1124/1 dhe 1124/2), dhe duke kërkuar kompensim për pamundësinë që të shfrytëzojë pronën e tij që nga 1999. Nuk është e qartë nëse këto procedura janë akoma në pritje për t'u trajtuar.

12. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

B. Procedura në Agjencinë Kosovare të Pronës

13. Më 2 maj 2006, ankuesi po ashtu parashtroi tri kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) për njohje të pronësisë së disa pronave (parcelat kadastrale me nr. 1124/1, 1124/2, 1076 dhe 882) që ndodhen në komunën e Obiliqit.

14. Komisioni për Kërkesa Pronësore (KPCC) morri tri vendime për këto kërkesa, dy më 22 shkurt 2008 dhe të tretin më 23 tetor 2008. Me të tri këto vendime u konstatua se ankuesi ishte pronari i pronave në fjalë, dhe uzurpuesit u informuan se pronat duhet të lirohen brenda 30 ditëve nga dërgimi i urdhrit, përndryshe ata do të dëboheshin.

15. Këto vendime siç duket mbetën të pazbatuara. Nga informacionet e marra nga ankuesi shihet se ai është ankuar në gusht të vitit 2009 për moszbatimin e vendimeve nga AKP në Komisionin e Kërkesave Pronësore dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës.

16. Në një shkresë të datës 8 dhjetor 2009, AKP-ja i shpjegoi ankuesit se më 2 dhjetor 2009 Komisioni për Kërkesa Pronësore (KPCC) i kishte përmbysur të tri vendimet e

përmendura lart. Arsyeja për këtë ishte se pas ofrimit të qasjes në informacionet kadastrale nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, dhe pas rishqyrtimit të këtyre të dhënave, u konstatua se pronat për të cilat ishte parashtruar kërkesë ishin regjistruar gabimisht. Si pasojë, vendimet përkatëse paraprake lidhur me këto kërkesa konsiderohej se ishin ligjërisht jovalide dhe nuk duhej të përdoreshin në ndonjë transaksion ligjor apo për ndonjë përdorim tjetër lidhur me pronat për të cilat ishte parashtruar kërkesë. Në pajtim me procedurat e AKP-së, kërkesa dhe çfarëdo përgjigje apo informacion i pranuar duhej verifikuar dhe paraqitur KPCC-së për rivendosje.

17. Më 22 qershor 2011, KPCC mori vendim duke i dhënë ankuesit të drejtat pronësore për parcelat kadastrale me nr. 1124/1 dhe 1124/2.

18. Deri më sot, nuk janë marrë vendime nga KPCC lidhur me parcelat tjera që pohohet se janë në pronësi të ankuesit.

III. ANKESA

19. Ankuesi në esencë pohon se gjykata komunale e Prishtinës ka pezulluar procedurën lidhur me kërkesën për kompensim të parashtruar më 5 gusht 2004 kundër komunës së Obiliqit dhe IPVQ-ve për shkatërrimin e pronës së tij, dhe si pasojë këto procedura nuk janë përfunduar brenda një kohe të arsyeshme, duke shkelur nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ai pohon se për arsyen e njëjtë është shkelur edhe e drejta e tij për mjet efikas sipas nenit 13 të KEDNJ. Ankuesi gjithashtu ankohet se është shkelur e drejta e tij në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ) me shkatërrimin e pronës së tij dhe me refuzimin e gjykatës komunale të Prishtinës që të marrë vendim për kërkesën e tij për kompensim.

20. Ankuesi po ashtu pohon se gjykata komunale në Prishtinë ka vonuar procedurën lidhur me kërkesën e tij për dëbim të parashtruar më 10 shtator 2008 kundër dy të paditurve të cilët dihen me emra, dhe si pasojë këto procedura nuk janë përfunduar brenda një kohe të arsyeshme, duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ.

21. Përfundimisht, ai pohon shkelje të së drejtës së tij në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), si dhe të drejtën e tij për mjet efektiv (neni 13 i KEDNJ), si pasojë e dështimit të AKP-së që të implementojë vendimet e saj të datës 22 shkurt 2008 dhe 23 tetor 2008, me të cilat vendime u konstatua pronësia e tij mbi pronat për të cilat u parashtrua kërkesë.

IV. ZBATIMI I RREGULLËS 29*BIS* TË RREGULLORES SË PUNËS SË PANELIT

22. Paneli thekson se ankesa ngrit çështje të cilat, së paku për aq sa ankesa ka të bëjë me procedurën e iniciuar në vitin 2004 pranë gjykatës komunale në Prishtinë, janë esencialisht të njëjta sikurse ato që janë ngritur, në mes tjerash, në rastet me nr. 38/08, Milogorić, 58/08, Živaljević, 61/08, Gojković, 63/08 Ćukić, dhe 69/08, Bogićevć, të

cilat tanimë janë shqyrtuar nga Paneli. Për më tepër, nga dosja shihet se nuk është paraqitur ndonjë çështje e re për pranueshmërinë lidhur me këtë aspekt të lëndës aktuale. Prandaj, në pajtim me Rregullën 29*bis* të Rregullores së Punës së Panelit, Paneli konstaton se nuk është e nevojshme që këtë pjesë të kësaj ankese t'ia komunikojë UNMIK-ut. Paneli konsideron se mund të shqyrtojë pranueshmërinë e tërë ankesës pa e bërë këtë.

V. LIGJI

23. Para se të shqyrtohet rasti për bazueshmërinë e tij, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret për pranim të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut.

A. Procedura për kompensim pranë gjykatës komunale në Prishtinë, lidhur me kërkesën për kompensim kundër komunës së Obiliqit dhe IPVQ-ve.

Pohimi për shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNJ

24. Paneli konsideron se, përderisa ankuesi thirret në shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNJ, ai në fakt paraqet dy ankesa (shih qasjen e miratuar, në mes tjerash, në *Milogorić*, nr. 38/08, vendim i 22 majit 2009; krahaso Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), *Aćimović kundër Kroacisë*, nr. 48776/99, vendim i 30 majit 2000; GJEDNJ, *Kutić kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, vendim i 11 korrikut 2000). Në anën tjetër, ai ankohet për faktin se për shkak të pezullimit të procedurës në gjykatën kompetente, ai nuk ka pasur mundësi të merr vendim për kërkesat e tij për kompensim të pronës së dëmtuar. Paneli konsideron se kjo ankesë mund të ngrit çështjen e të drejtës së tij për qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ dhe të drejtës së tij për mjet të efektshëm sipas nenit 13 të KEDNJ. Në anën tjetër, ai ankohet për kohëzgjatjen e procedurës pranë gjykatave kompetente, nga fakti se procedura u iniciua në vitin 2004, dhe se kërkesat e tij nuk janë shqyrtuar që atëherë. Kjo ankesë mund të ngit çështjen e të drejtës së tij për të marrë një vendim gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNj.

25. Paneli konsideron se ankesa sipas neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNJ ngrit çështje serioze faktike dhe ligjore, vendosja e të cilave do të duhej të varet nga shqyrtimi i bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon se kjo ankesë nuk është e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (shih, në mes tjerash, HRAP, *Milogorić*, cituar në § 24 lart, në § 18).

26. Arsye tjera për shpalljen e kësaj pjese të ankesës të papranueshme nuk janë konstatuar.

Pohimi për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ

27. Ankuesi ankohet për shkelje të së drejtës së tij në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1). Ai përgjithësisht ankohet për faktin se prona e tij është dëmtuar ose shkatërruar, dhe ankohet për dështimin e gjykatës komunale të Prishtinës të vendosë për kërkesën e tij për dëmshpërblim.

28. Paneli përkujton se, sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai ka juridiksion vetëm për "ankesat që kanë të bëjnë me pohimin për shkelje të të drejtave të njeriut që kishin ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 ose që dalin nga faktet që janë paraqitur para kësaj date kur këto fakte paraqesin shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Dëmtimi dhe shkatërrimi i pronës janë akte të atypëratyshme, të cilat nuk paraqesin shkelje të vazhdueshme (shih HRAP, *Lajović*, nr. 09/08, vendim i 16 korrikut 2008, § 7). Duke pasur parasysh se dëmi në pronën e tij u shkaktua siç pohohet në vitin 1999, rrjedh se kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit kohor të Panelit (*ratione temporis).*

29. Për sa i përket ankesës se, për shkak të pezullimit të procedurës së iniciuar lidhur me kërkesën e ankuesit, ai nuk ka mundur të merr kompensim për dëmin e shkaktuar pronës së tij, Paneli thekson se, përderisa procedurës gjyqësore i referohemi nga pikëvështrimi i së drejtës në pronë, këto procedura nuk mund të shkëputen nga aktet në të cilat bazohen kërkesat e parashtruara pranë gjykatave. Ose, thënë më konkretisht, ashtu siç ka vepruar Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut lidhur me juridiksionin e saj sipas KEDNJ:

> "…Juridiksioni kohor i gjykatës duhet të përcaktohet në relacion me faktet që përbëjnë bazën e ndërhyrjes së pohuar. Dështimet që pasuan në shfrytëzimin e mjeteve për korrigjimin e kësaj ndërhyrjeje nuk mund ta përfshijnë çështjen brenda juridiksionit kohor të Panelit" (GJEDNJ (Grand Chamber), *Blečič kundër Kroacisë*, nr. 59532/00, aktgjykim i 8 marsit 2006, § 77, KEDNJ, 2006-III).

30. Rrjedh se kjo pjesë e ankesës është po ashtu jashtë juridiksionit kohor të Panelit (*ratione temporis)* (shih, në mes tjerash, HRAP, *Gojković*, nr. 63/08, vendim i 4 qershorit 2009, §§ 24-25).

B. Procedura e dëbimit pranë gjykatës komunale në Prishtinë, lidhur me kërkesën për dëbim

31. Ankuesi gjithashtu ankohet se gjykata komunale në Prishtinë ka vonuar procedurën lidhur me kërkesën e tij për dëbim të parashtruar më 10 shtator 2008 kundër dy të paditurve të cilët dihen me emra, dhe se si pasojë këto procedura nuk janë përfunduar brenda një kohe të arsyeshme, duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ.

32. Lidhur me këtë ankesë, Paneli thekson se më pak se tre muaj pasi u parashtrua kjo ankesë, EULEX-i mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit (shih § 12 lart).

33. Për periudhën e shkurtër gjatë së cilës UNMIK-u akoma ishte përgjegjës për funksionimin e gjykatave, Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës është e pabazuar në shikim të parë.

34. Sa i përket periudhës pas 9 dhjetorit 2008, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.

C. Pohimi për mosimplementim të vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës

35. Ankuesi po ashtu ankohet se AKP nuk implementoi vendimet e marra nga KPCC në vitin 2008, me të cilat vendime u konstatua pronësia e ankuesit për pronat e pretenduara (parcelat kadastrale nr. 1124/1, 1124/2, 1076, dhe 882) që ndodhen në komunën e Obiliqit.

36. AKP-ja i dërgoi një shkresë ankuesit më 8 dhjetor 2009, duke shpjeguar se arsyeja për mosimplementim të vendimeve ishte se më 2 dhjetor 2009, KPCC i kishte përmbysur të tri vendimet që i kishte marrë më herët sepse pronat e pretenduara ishin regjistruar gabimisht. Paneli thekson se më 22 qershor 2011, KPCC morri vendim duke i njohur ankuesit të drejtat pronësore për parcelat kadastrale me nr. 1124/1 dhe 1124/2 (shih § 17, lart).

37. Paneli thekson se sa i përket kontrollit administrativ të UNMIK-ut mbi AKP-në, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së, në raportin e tij drejtuar Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Misionin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, të datës 17 mars 2009, thekson se meqë autoriteti i UNMIK-ut mbi AKP-në nuk u vazhdua pas 31 dhjetorit 2008, autoritetet e Kosovës dhe një drejtor ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar / Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian, morri kontrollin e plotë operacional mbi AKP-në. Pas kësaj, AKP-ja funksiononte në pajtim me legjislacionin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës (S/2009/149, § 24; shih HRAP, *Kušić*, nr. 08/07, mendim i 15 majit 2010, § 51).

38. Për më tepër, në *Kušić* (cituar lart në § 37, në § 52) Paneli tanimë e ka gjykuar se, nga 31 dhjetori 2008, UNMIK-u më nuk mund të mbahet përgjegjës për veprimet apo mosveprimet që i vishen AKP-së.

39. Si rrjedhojë, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.

PËR KËTO ARSYE**,**

Paneli unanimisht,

- SHPALL TË PRANUESHME ANKESAT QË KANË TË BËJNË ME TË DREJTËN PËR QASJE NË GJYKATË DHE TË DREJTËN PËR MJET TË

EFEKTSHËM (NENET 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT), DHE TË DREJTËN PËR VENDIM GJYQËSOR BRENDA NJË KOHE TË ARSYESHME (NENI 6 § 1 I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT) LIDHUR ME PROCEDURËN E INICUAR NË VITIN 2004 PRANË GJYKATËS KOMUNALE NË PRISHTINË;

- E SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN E MBETUR TË ANKESËS.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar